

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet organizimi, kompetencat dhe puna e organeve të administratës shtetërore.

Neni 2

Organet e administratës shtetërore, si pjesë e pushtetit ekzekutiv, themelohen në sferat dhe fushat të cilat janë me rëndësi për kryerje të funksioneve të shtetit dhe për realizimin efikas të të drejtave dhe obligimeve të qytetarëve dhe personave juridik.

Neni 3

Organet e administratës shtetërore kompetencat e tyre të përcaktuara me këtë ligj i kryejnë në bazë të principeve të ligjshmërisë, përgjegjësisë, efikasitetit, ekonomisë, transparencës, barazisë dhe parashikueshmërisë.

Neni 4

(1) Organet e administratës shtetërore në suaza të kompetencave të tyre janë të obliguar t'u sigurojnë qytetarëve realizim efikas dhe ligjor të lirive dhe të drejtave të tyre kushtetuese.

(2) Organet e administratës shtetërore në suaza të kompetencës së tyre sigurojnë realizim efikas dhe ligjor të të drejtave dhe interesave të përcaktuara me ligj për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën administrative.

Neni 5

(1) Organet e administratës shtetërore, mund të themelohen si ministri, organe tjera të administratës shtetërore dhe organizata administrative.

(2) Ministrinë themelohen për kryerje të funksioneve të administratës shtetërore të grupuara sipas sferave për një ose më shumë departamente administrative të ngjashme.

(3) Organe të tjera të administratës shtetërore mund të themelohen si organe të pavarura të administratës shtetërore ose organe në përbërje të ministrive.

(4) Organet e pavarura të administratës shtetërore mund të krijohen vetëm nëse resorët administrativë për të cilët themelohen nuk janë në kompetencë të asnjë ministrie dhe nevojitet pavarësia e tyre e plotë nga ministrinë dhe përgjegjësia e drejtpërdrejtë para Qeverisë.

(5) Organet në përbërje të ministrive mund të themelohen për kryerje të punëve të caktuara administrative, profesionale dhe tjera nga kompetenca e ministrisë.

(6) Organizatat administrative themelohen për kryerje të punëve të caktuara profesionale dhe tjera të cilat kërkojnë zbatim në mënyra dhe metoda profesionale dhe punë administrative të lidhura me ato nga sferat për të cilat themelohen ministri.

(7) Organizatat administrative themelohen si organe të pavarura të administratës shtetërore.

Neni 6

Organi i pavarur i administratës shtetërore për punën e tij përgjigjet te Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Organet e administratës shtetërore, përveç ministrive, mund të themelohen dhe të pezullohen dhe kompetenca e tyre të përcaktohet me ligj.

Neni 7-a

(1) Ligji me të cilin propozohet themelimi i organit tjetër të administratës shtetërore ose organizatës administrative detyrimsht përmban edhe vlerësimin e ndikimit të rregullativës për themelimin e organit të ri të administratës shtetërore ose organizatës administrative.

(2) Teksti i ligjit me të cilin propozohet themelimi i organit tjetër të administratës shtetërore, përkatësisht organizatës administrative, e të cilin e propozon Qeveria, përcaktohet pas mendimit pozitiv të marrë paraprakisht për vlerësimin e ndikimit të rregullativës për themelimin e organit të ri të administratës shtetërore ose organizatës administrative nga paragrafi (1) i këtij neni nga ministri i cili udhëheq ministrinë kompetente për kryerjen e punëve në fushën e administratës shtetërore dhe ministri i cili udhëheq ministrinë kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e financave.

(3) Tekstin e ligjit me të cilin propozohet bashkimi ose shuarja e organit tjetër të administratës shtetërore ose organizatës administrative e përcakton Qeveria pas marrjes së mendimit pozitiv paraprakisht nga ministri i cili udhëheq ministrinë kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e administratës shtetërore.

(4) Forma dhe përmbajtja e formularit për vlerësimin e ndikimit të rregullativës për themelimin e organit të ri të administratës shtetërore ose organizatës administrative rregullohen me vendim, të cilin me propozimin e ministrit që udhëheq ministrinë kompetente për kryerjen e punëve në sferën e administratës shtetërore, e miraton Qeveria.

Neni 8

Organeve të veçanta të administratës shtetërore, me ligjin me të cilin themelohen mund t'u përcaktohet cilësi e personit juridik.

Neni 9

(1) Organet e administratës shtetërore e informojnë publikun për punën e tyre në përputhje me Kushtetutën dhe me këtë ligj.

(2) Organet e administratës shtetërore nuk japin të dhëna të cilat kanë të bëjnë me sigurinë nacionale, zyrtare dhe fshehtësinë e biznesit, si dhe me të dhënat personale për qytetarët në përputhje me ligj me të cilin rregullohet mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve.

Neni 10

Organet e administratës shtetërore gjatë përgatitjes së ligjeve dhe rregulloreve tjera në kompetencë të tyre sigurojnë konsultime me qytetarët përmes:

1) shpalljes publike të llojit, përmbajtjes dhe afateve për miratim të ligjeve dhe rregulloreve tjera;

2) organizimit të tribunave publike dhe

3) mbledhjes së mendimit nga shoqëritë e interesuara të qytetarëve dhe personave tjerë juridik dhe ngjashëm.

II. ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

1. Organizimi i organeve të administratës publike

Neni 11

Për kryerjen e funksioneve të administratës shtetërore themelohen ministratë në vijim:

1. Ministria e Mbrojtjes;
2. Ministria e Punëve të Brendshme;
3. Ministria e Drejtësisë;
4. Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive;
5. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Tregtisë së Jashtme;
6. Ministria e Çështjeve Evropiane;
7. Ministria e Financave;
8. Ministria e Ekonomisë dhe e Punës;
9. Ministria e Energjetikës, Xehetarisë dhe e Lëndëve të Para Minerale;
10. Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Ekonomisë së Ujërave;
11. Ministria e Shëndetësisë;
12. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës;
13. Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e të Rinjve;
14. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale;
15. Ministria e Kulturës dhe e Turizmit;
16. Ministria e Transformimit Digjital;
17. Ministria e Administratës Publike;
18. Ministria e Transportit;
19. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor dhe
20. Ministria e Sportit.

Neni 12

(1) Si organe të pavarura të administratës shtetërore themelohen:

- Komisioni për marrëdhënie me bashkitë fetare dhe grupet religjioze;
- Agjencia për Agjencia për emigracion;
- Agjencia për ushqim dhe veterinar e Republikës së Maqedonisë,²

(2) Si organizata administrative themelohen:

- Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë;
- Enti shtetëror për statistikë.

2. Kompetenca e organeve të administratës shtetërore

Neni 13

Organet e administratës shtetërore duke vepruar në suaza të kompetencave të tyre në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare:

- 1) e zbatojnë politikën për zbatim të ligjeve dhe rregulloreve tjera të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe rregulloret e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Qeveria)
- 2) janë përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera;
- 3) i zbatojnë drejtimit dhe qëndrimet e Qeverisë për punën e organeve të administratës shtetërore;
- 4) e ndjekin dhe janë përgjegjëse për gjendjen në sferat për të cilat janë themeluar;
- 5) japin iniciativë për zgjidhjen e pyetjeve në sferat për të cilat janë krijuar;
- 6) vendosin në punët administrative;
- 7) kryejnë mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e akteve dhe punën e shoqërive tregtare, institucionet dhe personat tjerë juridik kur për atë janë autorizuar me ligj;
- 8) kryejnë mbikëqyrje administrative dhe inspektuese dhe punë tjera administrative kur për atë janë të autorizuar me ligj;
- 9) i përgatisin propozim ligjet, propozues i autorizuar i të cilëve është Qeveria;
- 10) i përgatisin rregulloret që i sjell Qeveria dhe
- 11) kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me Kushtetutën dhe me ligj.

Neni 14

(1) Me ligj njërive të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit mund t'u besohet kryerje e punëve të caktuara nga kompetenca e organeve të administratës shtetërore.

(2) Ligjet dhe rregulloret të cilat kanë të bëjnë me organet e administratës shtetërore zbatohen edhe nga ana e personave fizik dhe juridik të cilët me ligj janë autorizuar të kryejnë punë nga kompetenca e administratës shtetërore.

Neni 15

Ministria e Mbrojtjes i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- realizimin e sistemit të mbrojtjes të pavarësisë dhe integritetit territorial të Republikës së Maqedonisë;
- planifikimin, organizimin, pajisjen, zhvillimin dhe përgatitjen e Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe zbatimin e planeve të përcaktuara;
- organizimin dhe përgatitjen e mbrojtjes;
- organizimin dhe zbatimin e trajnimit për mbrojtje;
- mbikëqyrjen në kompetencë të saj dhe
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 16

(1) Ministria e Punëve të Brendshme i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- realizimin e sistemit të sigurisë publike;
- paraqitjen e vendbanimit dhe vendqëndrimin;
- nënshtetësinë dhe pasaportat për kalimin e kufirit shtetërorë;
- lëvizjen dhe qëndrimin në zonën kufitare;
- sigurimin e kufirit shtetëror, kontrollin për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe punë të caktuara në lidhje me vërtetimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare dhe dëmtime tjera të kufirit;
- qëndrimi dhe lëvizja e të huajve;
- prodhimin, qarkullimin, magazinimin dhe mbrojtjen nga lëngjet djegëse, gazrat, eksplozivët dhe materialet tjera të rrezikshme dhe transportin e këtyre materialeve;
- dhënien e ndihmës gjatë fatkeqësive elementare dhe epidemive;
- furnizimin, posedimin, bartjen dhe kontrollin e shënjimit të armës dhe municionit;
- mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
- kryerjen edhe të punëve tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërje të Ministrisë së Punëve të Brendshme është Byroja për Siguri Publike.

Neni 17

(1) Ministria e Drejtësisë i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- gjykatën, prokurorinë publike, avokatinë publike;
- përgjegjësinë penale dhe përgjegjësinë për kundërvajtje;
- punë të notariatit, avokaturës dhe lloje tjera të ndihmës juridike;
- trashëgiminë, pronësinë, të drejtat reale dhe marrëdhëniet obligative;
- ndihmën ndërkombëtare juridike;
- zbatimin e sanksioneve për vepra penale dhe kundërvajtje;
- organizimin dhe udhëheqjen me institucionet ndëshkuese-përmirësuese dhe edukuese-përmirësuese;
- amnistinë dhe faljen;
- ekspertizat gjyqësore, ekspertizat dhe super-ekspertizat;
- sistemin zgjedhor, mbajtjen e evidencës dhe të drejtën për votim;
- procedurën penale, kundërvajtëse, kontestimore, jashtëkontestimore, të zbatimit;
- kryerjen e punëve që bien në kompetencë të organit tjetër të administratës shtetërore dhe
- kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërjen e Ministrisë së Drejtësisë janë:

- Drejtoria për zbatimin e sanksioneve dhe
- Byroja për vlerësim..3

(3) Byroja për vlerësim. dhe Drejtori për zbatimin e sanksioneve kanë cilësinë e personit juridik.4

Neni 17-a

- (1) Ministria për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive i kryen punët që kanë të bëjnë me:
- sigurimin dhe koordinimin e mbështetjes së Qeverisë në realizimin e prioriteteve strategjike të lidhur me detyrimet që dalin nga Marrëveshja Kornizë,
 - sigurimin dhe realizimin e mjeteve financiare të nevojshme për zhvillim të suksesshëm të procesit të realizimit të detyrimeve të cilat dalin nga Marrëveshja Kornizë në kuadër të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe nga donatorët,
 - sigurimin e koordinimit dhe harmonizimit e punës së organeve të administratës shtetërore për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë,
 - avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të bashkësive si grup i shtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili tradicionalisht jeton në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast pjesëtarët e tij kanë veçori të ndryshme etnike, gjuhësore, kulturore, religjioze e të tjera dhe i mban dëshira për mbrojtje dhe kultivim të atyre veçorive,
 - ndjekjen dhe zbatimin e të drejtës së përdorimit të gjuhëve dhe alfabetëve të bashkësive,
 - garantimin e mbrojtjes së identitetit etnik, kulturor, gjuhësor të bashkësive,
 - bashkëpunimin ndërkombëtar për çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive,
 - çështje tjera që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet bashkësive,
 - ndjekjen e gjendjes në marrëdhëniet ndërmjet bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut në nivel nacional, në rajone dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe përgatitjen e raporteve dhe rekomandimeve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive,
 - promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e gjuhës që e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
 - dhënien e mbështetjes së Qeverisë në sigurimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive në organet e administratës shtetërore,
 - dhënien e mbështetjes në përgatitjen e metodologjisë për miratimin e planeve aksionale të Qeverisë në sferën e përfaqësimit të drejtë gjatë punësimit,
 - dhënien e mbështetjes në koordinimin e aktiviteteve me organet e administratës shtetërore dhe me donatorët dhe
 - kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.

- (2) Në përbërje të Ministrisë për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive janë:
- Drejtoria për zhvillim dhe avancim të arsimit në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive;
 - Drejtoria për afirmim dhe avancim të kulturës së pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

Neni 18

- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme i kryen punët që kanë të bëjnë me
- punët e jashtme dhe politikën e jashtme të Republikës së Maqedonisë;
 - vendosjen, zhvillimin dhe koordinimin e marrëdhënieve, përfaqësimin dhe afirmimin e Republikës së Maqedonisë në planin ndërkombëtar;
 - mbrojtjen e interesave, të drejtave dhe pronave të Republikës dhe shtetasve të saj dhe të drejtat juridike vendase në vend të huaj;
 - koordinimin dhe njoftimin për politikën nga kompetenca për të cilën është krijuar;
 - organizimin dhe udhëheqjen me përfaqësitë diplomatike, konsullore dhe tjera të Republikës së Maqedonisë, si dhe organizimi i sistemit të lidhjeve me to;
 - lidhjen, ratifikimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare;
 - përcaktimin dhe shënjinin e kufirit shtetëror;
 - komunikimin dhe bashkëpunimin me përfaqësitë e huaja diplomatike dhe konsullore të vendeve të huaja dhe misionet e organizatave ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë;
 - akreditimin e ambasadorëve, pranimin e letrave akredituese, dhënien e privilegjeve dhe imunitetit përfaqësive të huaja diplomatike dhe përfaqësive të organizatave qytetare ndërkombëtare dhe punë tjera në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e ambasadorëve të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit;
 - mbledhjen, studimin dhe kujdesin për dokumentacionin e huaj dhe vendor nga kompetenca e saj;
 - monitorimin e lëvizjeve ekonomike ndërkombëtare, si dhe ndikimin e tyre në marrëdhëniet ekonomike

në Republikë;
 - punën e tregtisë së jashtme;
 - përmirësimin e marrëdhënieve ekonomike me vendet e huaja;
 - propozimin dhe zbatimin e masave në fushën e marrëdhënieve ekonomike me vendet e huaja, monitorimin e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare dhe bashkëpunimin shumëpalësh, rajonal dhe dypalësh me vende dhe organizata të tjera dhe zhvillimin e tyre;
 - krijimin, zbatimin, propozimin dhe përmirësimin e regjimit të politikës së tregtisë së jashtme, duke përfshirë masat mbrojtëse në tregtinë e jashtme;
 - harmonizimin e normave të shkëmbimit tregtar të jashtëm me normat e Bashkimit Evropian dhe Organizatës Botërore të Tregtisë dhe institucioneve dhe organizatave të tjera shumëpalëshe dhe zbatimin e tyre;
 - lidhjen dhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve tregtare ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dhe kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 18-a

(1) Ministria e Çështjeve Evropiane i kryen punët që kanë të bëjnë me:
 - sigurimin e koordinimit dhe harmonizimin e punës së organeve të administratës shtetërore dhe organeve dhe institucioneve të tjera, për përgatitjen e Republikës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përfshirë negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
 - sigurimin e koordinimit të aktiviteteve për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit të lidhur ndërmjet Republikës dhe Bashkësive Evropiane dhe vendeve anëtare të tyre dhe marrëveshjeve të tjera të lidhura ndërmjet Republikës dhe Bashkimit Evropian, si dhe trupave të punës të formuar në kuadër të marrëveshjes së lidhur dhe marrëveshjeve të tjera me Bashkimin Evropian;
 - sigurimin e koordinimit të procesit të përgatitjes së versionit maqedonas të të drejtës së Bashkimit Evropian (acquis communautaire);
 - sigurimin e koordinimit me qëllim të harmonizimit të punës së përfaqësuesve të Republikës në institucionet dhe trupat e Bashkimit Evropian;
 - sigurimin e koordinimit me qëllim të harmonizimit të punës së Republikës si shtet anëtar i Bashkimit Evropian;
 - sigurimin e koordinimit të ndihmës së huaj nga Bashkimi Evropian dhe vendet anëtare të tij dhe ndihma të tjera të huaja në lidhje me reformat plotësuese të procesit të integritetit të Republikës në Bashkimin Evropian;
 - informimin e publikut për aktivitetet në lidhje me procesin e integritetit evropian dhe çështjet evropiane;
 - si dhe punë të tjera që kanë të bëjnë me Bashkimin Evropian që do t'i përcaktojë nga Qeveria;
 - dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 19

(1) Ministria e Financave i kryen punët që kanë të bëjnë me:
 - sistemin e financimit;
 - sistemin e thesarit;
 - sistemin doganor;
 - sistemin tatimor dhe politikën tatimore;
 - sistemin e punës devizore;
 - sistemin e bankave dhe kursimoreve dhe institucioneve tjera financiare;
 - sistemin e kontabilitetit, revizionit dhe qarkullimit pagesor;
 - huamarrjet dhe kreditë;
 - politikën makroekonomike dhe politikën për zhvillim të ekonomisë nacionale;
 - përgatitjen e projekt të bilancit pagesor;
 - përgatitjen dhe ndjekjen e balanceve makroekonomike;
 - sigurimin e pronës dhe njerëzve;
 - lojërat e fatit;
 - përgatitjen dhe realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe të llogarisë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë;
 - pronësinë dhe punë tjera pronësore-juridike;
 - rezervat e mallrave

- mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
- kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj.

- (2) Në përbërjen e Ministrisë së Financave janë:
- Drejtoria për punë pronësore-juridike;
 - Drejtoria doganore;
 - Byroja për furnizime publike;
 - Drejtoria për Zbulim Financiar;
 - Drejtoria për policinë financiare;
 - Drejtoria për furnizime publike.

- (3) Drejtoria për të hyra publike dhe Drejtoria doganore kanë cilësinë e personit juridik.

Neni 20

- (1) Ministria e Ekonomisë dhe e Punës i kryen punët që kanë të bëjnë me:
- ndjekjen e gjendjes dhe dukurive të tregut të mallrave dhe shërbimeve dhe ndikimin e masave të ekonomike;
 - ndjekjen e gjendjeve ekonomike, strukturore dhe tekniko-teknologjike dhe propozimi i masave për zbatimin e politikës zhvillimore dhe aktuale ekonomike në sferën e prodhimit, tregtisë, hotelarisë dhe zejtarisë;
 - ndërmarrjen e masave kundër pozitës monopoliste dhe sjelljes monopoliste;
 - ndjekjen e bilanceve materiale vijuese dhe furnizimin e qytetarëve me prodhime ushqimore bazë dhe mallra tjera për konsumim të gjerë dhe ndërmarrjet me resurse dhe repromateriale;
 - sistemin dhe politikën e çmimeve të prodhimeve dhe shërbimeve;
 - përgatitjen e programit për zhvillim material global të resurseve njerëzore;
 - mbrojtjen e konsumatorëve;
 - ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe kooperativat;
 - marrëdhëniet e punës, punësimin dhe punësinë;
 - mbrojtjen e të punësuarve gjatë punës;
 - sigurimin material për të punësuarit e përkohshëm;
 - rrogat dhe standardin e jetesës;
 - mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
 - kryerjen edhe të punëve të përcaktuara me ligj.

- (2) Në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Punës është:
- Drejtoria për Prodhim të Destinuar.

Neni 20-a

- (1) Ministria e Energjetikës, e Xehetarisë dhe e Lëndëve të Para Minerale i kryen punët që kanë të bëjnë me:
- energjetikën, politikën energjetike dhe planifikimin e zhvillimit në fushën e energjisë elektrike, gazit natyror, naftës dhe derivateve të naftës, energjisë termike dhe ujërave termale, si dhe llojeve të tjera të energjisë dhe shfrytëzimin e tyre;
 - furnizimin me energji;
 - zbatimin e procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e organeve udhëheqëse, drejtuese dhe mbikëqyrëse në personat juridikë nga fusha e energjetikës në pronësi të plotë ose dominuese shtetërore;
 - strategjinë dhe politikën për sigurinë energjetike;
 - përdorimin racional të energjisë dhe efikasitetit energjetik, burimet rigjeneruese të energjisë;
 - koordinimin e punës dhe realizimin e investimeve energjetike;
 - xehetarinë, strategjinë dhe politikën për zhvillimin e xehetarisë;
 - eksplotimin e lëndëve të para minerale dhe resurseve gjeologjike;
 - hulumtimet gjeologjike dhe hulumtimet lidhur me shfrytëzimin e lëndëve të para minerale;
 - përpilimin e programit për punë hulumtuese në fushën e hulumtimeve bazë gjeologjike lidhur me përdorimin e resurseve;
 - qendrueshëm të resurseve;

- mbikëqyrjen në kompetencë të saj dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërje të Ministrisë së Energjetikës, të Xehetarisë dhe të Lëndëve të Para Minerale është Byroja e Metrologjisë.

(3) Byroja e Metrologjisë e ka cilësinë e personit juridik.

Neni 21

(1) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- bujqësinë, pylltarinë dhe ekonominë e ujërave;
- shfrytëzimin e tokës bujqësore, pyjeve dhe pasurive tjera natyrore;
- gjuetinë dhe peshkatarinë;
- mbrojtjen e bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit;
- zbatimin e politikës në sferën e sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe shëndetësinë veterinarë;
- ndjekjen dhe studimin e gjendjeve me ujërat, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e regjimit të ujërave;
- sistemet hidromeliorative;
- matjet hidrologjike dhe agrometrologjike, si dhe mbrojtja anti breshër;
- studimi dhe hulumtimi i paraqitjeve dhe proceseve meteorologjike, hidrologjike dhe biometeorologjike;
- mbikëqyrja nga kompetenca e saj dhe
- kryerjen edhe të punëve tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërjen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave janë:

- Drejtoria e ujërave;
- Drejtoria e punëve hidrometeorologjike;
- Drejtoria për fara dhe material për mbëltim;
- Drejtoria Fitosanitare.

(3) Drejtoria për punë hidrometeorologjike ka cilësinë e personit juridik.

Neni 22

(1) Ministria e Shëndetësisë i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- mbrojtjen shëndetësore dhe sigurimin shëndetësor të popullatës;
- ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe produkteve jetësore;
- organizimin dhe zhvillimin e shëndetit;
- ndjekja e gjendjes shëndetësore e popullatës;
- mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet infektuese, nga ndikimi i dëmshëm i gazrave, rrezet jonizuese, zhurma, ndotja e ajrit, ujit dhe tokës;
- sendet për shfrytëzim të përgjithshëm;
- gjendjen higjieno-epidemiologjike;
- barërat, mjetet shëruuese ndihmëse, mjetet mjekësore, pajisjet mjekësore, mjetet dhe materialet sanitare
- helmet dhe drogat narkotike;
- mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
- kryerjen edhe të punëve tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 23

(1) Ministria e Arsimit dhe Shkencës i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- edukimin dhe arsimin nga të gjitha llojet dhe shkallët;
- organizimin, financimin, zhvillimin dhe përparimin e edukimit, arsimit dhe shkencës;
- edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të punëtorëve tanë me punë dhe qëndrim të përkohshëm jashtë vendit;
- verifikimin e profesioneve dhe profileve në arsim;
- standardin e nxënësve dhe studentëve;

- bashkëpunimin nga ndërkombëtar shkencor-teknik;
- mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
- kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës janë:
 - Shërbimi pedagogjik dhe
 - Byroja për zhvillim të arsimit.

(3) Byroja për zhvillim të arsimit ka cilësinë e personit juridik.

Neni 24

- (1) Ministria për Politikë Sociale, Demografi dhe të Rinj i kryen punët që kanë të bëjnë me:
- sigurimin pensional dhe invalidor;
 - politikën sociale;
 - politikën humane me qëllim të zhvillimit të balancuar ekonomik;
 - marrëdhëniet juridike në martesë, familje dhe bashkësinë jashtëmartesore;
 - marrëdhëniet në mes prindërve dhe fëmijëve, kujdestarinë dhe adoptimin;
 - përparimin e barazisë në mes gjinive;
 - mbrojtjen e fëmijëve dhe personave të mitur;
 - mbrojtjen e rinisë dhe grave;
 - mbrojtjen e personave me pengesa në zhvillim;
 - mbrojtjen e invalidëve civil nga lufta dhe familjen mbajtësi i të cilëve është në shërbim të obliguar ushtarak;
 - mbrojtjen e luftëtarëve nga lufta Antifashiste dhe nga të gjitha luftërat nacionale çlirimtare të Maqedonisë, të invalidëve të luftës, e të ndjekurve dhe të burgosurve për idetë e pavarësisë të popullit maqedonas dhe shtetësinë e saj, si dhe të anëtarëve të familjeve të tyre të cilët nuk kanë mundësi për ekzistencë materiale dhe sociale.
 - planifikimin familjar;
 - familjen dhe fëmijët;
 - përgatitjen dhe zhvillimin e politikës demografike dhe politikës lidhur me migrimet;
 - përgatitjen dhe zhvillimin e politikës për të rinjtë;
 - kujdesin për zhvillimin psikofizik të të rinjve dhe mbrojtjen e tyre;
 - nxitjen dhe ndihmën e formave të organizimit të të rinjve;
 - ndërmarrjen e aktiviteteve për krijimin e kushteve për mbajtjen e të rinjve të aftë dhe të talentuar në Republikë, si dhe krijimin e kushteve për stimulimin e kthimit të tyre;
 - nxitjen e punësisë së të rinjve;
 - mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
 - kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërje të Ministrisë së Politikës Sociale, të Demografisë dhe të Rinjve është Drejtoria për Çështjet e Luftëtarëve dhe Invalidëve të Luftës.

Neni 25

- (1) Ministria e Vetadministrimit Lokal i kryen punët që kanë të bëjnë me:
- ndjekjen e zhvillimit dhe propozimin e masave për përparim të vetadministrimit lokal;
 - ndjekjen e gjendjes për ndarjen territoriale dhe zhvillimin e standardeve për madhësinë, popullatën dhe nevojat e njësive të vetadministrimit lokal;
 - propozimin e sistemit, politikës, masave dhe instrumenteve për realizim sa më të barabartë të zhvillimit regjional dhe për nxitjen e zhvillimit të zonave ekonomike jo mjaftueshëm të zhvilluara;
 - realizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve të dedikuara për zonat ekonomike jo mjaftueshëm të zhvilluara;
 - mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
 - kryerjen edhe të punëve tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërje të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale është Byroja për Zhvillim Rajonal.

(3) Byroja për zhvillimin rajonal ka cilësinë e personit juridik.

Neni 26

- (1) Ministria e Kulturës dhe e Turizmit i kryen punët që kanë të bëjnë me:
- ndjekjen, analizën dhe propozimin e akteve dhe masave për zhvillim dhe përparim të kulturës;
 - zbatimin, mbrojtjen, promovimin dhe pasurimin e gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj cirilik;
 - organizimin, financimin dhe zhvillimin e rrjetit të institucioneve nacionale dhe financimin e programeve dhe projekteve me interes nacional nga kjo sferë;
 - mbrojtjen e pasurisë kulturore;
 - veprimtarinë botuese, muzikore, skenike-artistike, filmike, të galerisë, bibliotekave, arkivore, të muzeve dhe kinematografike, veprimtarinë e shtëpive të kulturës dhe veprimtaritë për ndërmjetësim në kulturë;
 - mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta;
 - shënimin me përmendore të ngjarjeve dhe personave të shquar me interes nacional;
 - planifikimin integral të zhvillimit të turizmit dhe aktiviteteve plotësuese;
 - zhvillimin, shpalljen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të hapësirës turistike dhe destinacioneve turistike me rëndësi për turizmin;
 - promovimin e turizmit brenda dhe jashtë vendit;
 - përmirësimin e sistemit të vlerës dhe konkurrencës së vendeve dhe produkteve turistike;
 - hulumtimin e tregut turistik dhe zhvillimin e sistemit turistik informues;
 - kushtet dhe mënyrën e kryerjes të veprimtarisë së agjencive turistike;
 - mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
 - kryerjen edhe të punëve tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 26-a

- (1) Ministria e Transformimit Digjital i kryen punët që kanë të bëjnë me:
- zhvillimin dhe promovimin e shoqërisë informatike;
 - zhvillimin teknologjik dhe kulturën teknologjike;
 - përgatitjen e dokumenteve strategjike në fushën e digjitalizimit;
 - organizimin dhe zbatimin e trajnimeve për aftësi digjitale;
 - sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit;
 - digjitalizimin e shërbimeve publike;
 - administrimin e bazës së integruar të të dhënave personale të popullsisë së Republikës dhe librat përkatës të evidencës;
 - krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të sistemeve të informacionit dhe komunikimit dhe pajisjes informatike brenda organeve të administratës shtetërore;
 - rrjetin e integruar të informacionit dhe komunikimit, bazat e të dhënave, lidhjen e ndërsjellë dhe shkëmbimin e informacioneve, aspektet e sigurisë dhe zhvillimin e infrastrukturës së organeve shtetërore, personat juridikë dhe personat e tjerë të cilëve u është besuar me ligj ushtrimi i autorizimeve publike;
 - monitorimin e situatës me teknologjitë e informacionit dhe telekomunikimit dhe futja e standardeve ndërkombëtare;
 - telekomunikimet dhe infrastrukturën e telekomunikimeve;
 - radiodifuzionin dhe infrastrukturën radiodifuzive;
 - zbatimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet në kompetencë të saj;
 - mbikëqyrjen në kompetencë të saj dhe
 - kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 26-b

- (1) Ministria e Administratës Publike i kryen punët që kanë të bëjnë me:
- rregullimin ligjor të çështjeve që lidhen me administratën;
 - mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit të vetëm të rregullave që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetërorë dhe publikë;
 - zhvillimin e politikës lidhur me të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe vlerësimin e nëpunësve shtetërorë dhe publikë;
 - klasifikimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, rrogat dhe kompensimet e rrogave të nëpunësve shtetërorë dhe publikë;
 - mbajtjen e Regjistrit për të punësuarit në sektorin publik;
 - përgatitjen e dokumenteve strategjike për funksionimin efikas dhe efektiv, trajnimin dhe zhvillimin

profesional të nëpunësve shtetërorë dhe publikë, organizimin dhe zbatimin e trajnimit;
 - zhvillimin dhe koordinimin e politikave në lidhje me menaxhimin e resurseve njerëzore;
 - reformat në administratën publike;
 - realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështje në kompetencë të saj;
 - administratën shtetërore;
 - procedurën administrative;
 - mbikëqyrjen administrative dhe
 - kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërje të Ministrisë së Administratës Publike është Inspektorati Shtetëror Administrativ.

Neni 27

(1) Ministria e Transportit i kryen punët që kanë të bëjnë me:
 - komunikacionin rrugor dhe infrastrukturën rrugore;
 - komunikacionin hekurudhor dhe infrastrukturën hekurudhore;
 - komunikacionin ajror dhe infrastrukturën ajrore;
 - lundrimin e brendshëm;
 - komunikacionin postar dhe infrastrukturën postare;
 - lloje tjera të transportit dhe infrastrukturës e cila është e nevojshme për kryerje të transportit (teleferikë dhe ski-lifte dhe ngjashëm);
 - punët banesore-komunale, infrastruktura kompetente, rregullimin e hapësirës dhe udhëheqjen me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës dhe
 - kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërje të Ministrisë së Transportit është:
 - Kapedania e limaneve.

Neni 28

(1) Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor i kryen punët që kanë të bëjnë me:
 - ndjekjen e gjendjes së mjedisit jetësor;
 - mbrojtjen e ujërave, mbjelljeve, florës, faunës, ajrit dhe shtresës së ozonit nga ndotja;
 - mbrojtjen nga zhurma, rrezatimi, mbrojtja nga biodiversiteti, gjeodiverziteti, parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura;
 - restaurimin e pjesëve të ndotura nga mjedisi jetësor;
 - propozimin e masave për tretman të mbeturinave të ngurta;
 - planifikimin hapësinor;
 - sistemin hapësinor informativ;
 - mbikëqyrjen nga kompetenca e saj dhe
 - kryerjen e punëve të përcaktuara me ligj.

(2) Në përbërje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor janë:
 - Drejtoria për mjedisin jetësor;
 - Shërbimi për sistemin informativ hapësinor dhe5

Neni 28-a

Ministria e Sportit i kryen punët që kanë të bëjnë me:
 - sistemin, zhvillimin dhe përparimin e sportit dhe kulturës fizike;
 - përpilimin dhe realizimin e strategjive për zhvillimin e sportit;
 - interesin publik në sport në kompetencë të Republikës në përputhje me ligjin;
 - pjesëmarrje në ndërtimin, pajisjen, mirëmbajtjen dhe disponimin me objekte sportive dhe infrastrukturën sportive në pronësi të shtetit;
 - krijimin e kushteve për qasje më të madhe në sport për të gjithë qytetarët;
 - zhvillimin e vlerave morale dhe etike në sport;
 - monitorimin, përcaktimin dhe mbështetjen e subjekteve në sport;
 - mbrojtjen nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes ndaj sportistëve, organizatave sportive dhe subjekteve të tjera në sferën e sportit;

- mbështetjen e sportistëve të rinj të talentuar;
- verifikimin e kualifikimeve të kuadrove profesionale në sferën e sportit;
- bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e sportit;
- mbikëqyrjen në sferën e sportit dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 29

(1) Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze i kryen punët që kanë të bëjnë me gjendjen juridike të bashkësive fetare dhe grupet religjioze, si dhe punët në lidhje me marrëdhëniet në mes shteteve, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze.

(2) Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze ka cilësinë e personit juridik.

Neni 30

I fshirë

Neni 31

(1) Agjencia për migrim i kryen punët që kanë të bëjnë me pozitën dhe të drejtat e emigrantëve nga Maqedonia; ndihmën për zhvillimin e tyre kulturor dhe përparimin e lidhjeve me ta dhe me organizatat e tyre; njoftimin e mërgimtarëve nga Maqedonia me gjendjen e Republikës së Maqedonisë; krijimin e kushteve për kthimin e mërgimtarëve në Republikën e Maqedonisë; krijimin e kushteve për përfshirjen e mërgimtarëve në jetën publike dhe ekonomike të Republikës së Maqedonisë dhe kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Agjencia për migrim ka cilësinë e personit juridik.

Neni 32

I fshirë

Neni 33

I fshirë

Neni 33-a

"(1) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Republikës së Maqedonisë i kryen punët që kanë të bëjnë me sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë; organizimin dhe përgjegjësinë në kryerjen e veprimtarisë veterinarë; realizimin, kontrollin, mbikëqyrjen dhe ndjekjen e aktiviteteve të veterinarisë në sferën e mbrojtjes shëndetësore të kafshëve; mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve lidhur me rritjen, ruajtjen, kujdesin dhe vendosjen e tyre, mbajtjen në ferma dhe shfrytëzimin, transportin, veprimin me kafshë për sigurimin e mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve; mbrojtjen dhe mirëqenien e qenve dhe kafshëve kanakare, kafshëve në kopshtet zoologjike dhe kafshëve që shfrytëzohen për qëllime eksperimentale dhe qëllime tjera shkencore; nusproduktet me origjinë shtazore; identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve të fermave dhe kafshëve tjera; preparatet mjekësore veterinarë; kontrollin e kualitetit të ushqimit me përjashtim të prodhimit bujqësor primar dhe punë tjera me rëndësi të shëndetësisë veterinarë, sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë.⁹

(2) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Republikës së Maqedonisë e ka cilësinë e personit juridik.

Neni 34

(1) Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë i kryen punët që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit arkivor me të cilin disponon Republika e Maqedonisë; rregullimin dhe përpunimin e materialit dhe kryen edhe hulumtime arkivore.

(2) Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedoniisë ka cilësinë e personit juridik.

Neni 35

/ fshirë¹⁰

Neni 36

(1) Enti shtetëror për statistikë i kryen punët që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore; ruan, prezanton dhe jep të dhëna statistikore dhe e përcakton saktësinë e tyre; bartësve të autorizuar për zbatim të hulumtimeve statistikore iu jep mendim për bazat metodologjike; përgatit prognoza statistikore; trende dhe modele dhe të dhëna dhe indikatorë tjerë analitik dhe kryen edhe punë tjera profesionale të përcaktuara me ligj.

(2) Enti shtetëror për statistikë ka cilësinë e personit juridik.

Neni 37

Qeveria, për nevojat e dy ose më shumë organeve të administratës shtetërore, mund të përcaktojë punët profesionale, administrative dhe tjera t'i kryejë shërbimi i përbashkët profesional ose organ tjetër i administratës shtetërore, nëse me ligj ndryshe nuk është përcaktuar.

III. MBIKËQYRJA DHE ORGANET PËR KRYERJE TË MBIKËQYRJES

1. Mbikëqyrja mbi punën e organeve të administratës shtetërore

Neni 38

(1) Mbikëqyrja mbi punën e organeve të administratës shtetërore e përfshin mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë dhe efikasitetin e punës së tyre.

(2) Mbikëqyrja nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet edhe mbi ndërmarrjet publike, shërbimet dhe institucionet publike, si dhe mbi personat fizik dhe juridik të cilëve me ligj iu është besuar kryerja e autorizimeve publike.

Neni 38-a

(1) Mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e rregulloreve të njësive të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit e kryen ministri kompetent për kryerje të punëve të vetadministrimit lokal.

(2) Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e punës së organeve të njësive të vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit kryhet nga organet e administratës shtetërore.

(3) Mbikëqyrjen mbi kompetencat e deleguara e kryen organi i administratës shtetërore kompetencat e të cilit janë të deleguara në njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qytetin e Shkupit.

Neni 39

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga nenet 38 dhe 38-a nga ky ligj, organi i autorizuar i administratës shtetërore është i obliguar ta informojë organin në të cilin e kryen mbikëqyrjen për parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara dhe t'i propozojë afat për mënjanimin e tyre.

(2) Nëse organi në të cilin është kryer mbikëqyrja nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk i mënjanon parregullsitë dhe mangësitë në afatin e përcaktuar, organi i autorizuar do të ndërmerr masa për mënjanimin e tyre.

(3) Në rastin kur parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme për realizimin e të drejtave dhe interesave të qytetarëve ose për punën e organit, organi i autorizuar nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar për atë menjëherë ta informojë Qeverinë.

(4) Për gjendjen e konstatuar organet e autorizuar nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të obliguar të propozojnë masa deri te Qeveria për mënjanimin e parregullsive dhe mangësive të përcaktuara në punën e organit.

Neni 40

(1) Mbikëqyrjen e kryen organi më i lartë i administratës shtetërore, përveç nëse me ligj ndryshe nuk është caktuar.

(2) Nëse mbikëqyrja kërkon kycje të organizatës së specializuar për kryerje të ekspertizës, organi nga paragrafi (1) i këtij neni mund të përcaktojë mbikëqyrjen ta kryejë organizata e specializuar për sferën përkatëse.

Neni 41

(1) Mbikëqyrjen mbi punën e ministrive e kryen Qeveria.

(2) Mbikëqyrjen mbi punën e organeve në përbërje me ministritë e kryejnë ministritë, kurse mbi organet tjera të administratës shtetërore ministria e cila është kompetente për sferën administrative për të cilën është edukuar organi i administratës shtetërore.

(3) Mbikëqyrjen mbi punën e organizatave administrative e kryen ministria nën kompetencë të së cilës është sfera administrative për të cilën është themeluar organizimi administrativ.

2. Mbikëqyrja inspektuese

Neni 42

Mbikëqyrja inspektuese përfshin mbikëqyrjen mbi implementimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera nga ana e organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike, shoqërive tregtare, institucioneve, personave fizik dhe juridik.

Neni 43

(1) Mbikëqyrjen inspektuese e kryejnë vetëm organet e administratës shtetërore në suaza të autorizimeve të tyre.

(2) Për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese mund të edukohet inspektorat si organ në përbërje të ministrive.

(3) Punët e mbikëqyrjes inspektuese i kryen inspektorati.

Neni 44

Secili ka të drejtë të merr iniciativë për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese dhe për ndërmarrje të masave përkatëse nga ministritë dhe organet e administratës shtetërore kompetente për mbikëqyrjen inspektuese.

Neni 45

Procedurën e mbikëqyrjes inspektuese inspektorati e ngrit dhe udhëheq me detyrë zyrtare, sipas rregullave të procedurës administrative.

Neni 46

Në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese inspektorati është i obliguar të veprojë në përputhje me ligjin dhe rregulloret tjera.

IV. UDHËHEQJA ME ORGANET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE MARRËDHËNIET MIDIS TYRE

Neni 47

(1) Me punën e ministrisë udhëheq ministri.

(2) Me punën e organit të pavarur të administratës shtetërore, organizatën administrative dhe organin në përbërje, udhëheqë drejtor të cilin e emëron dhe shkarkon nga detyra Qeveria, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 48

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë emëron dhe shkarkon zëvendës të ministrit në ministrinë përkatëse me propozim të kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(2) Zëvendësi e zëvendëson ministrin në rastet kur ai mungon ose kur për shkak të sëmundjes ose arsyeve tjera nuk ka mundësi ta kryen funksionin e vet, me të gjitha autorizimet dhe përgjegjësitë e tij në udhëheqje.¹¹

(3) Zëvendësi në bashkëpunim me ministrinë kryen punë nga kompetenca e ministrit të cilat ai do t'ia besojë

Neni 49

(1) Ministri e përfaqëson ministrinë, organizon dhe siguron kryerje ligjore dhe efikase të punëve dhe detyrave; miraton rregullore dhe akte tjera për të cilat është i autorizuar dhe ndërmerr edhe masa tjera nga kompetenca e ministrisë në përputhje me ligj; vendos për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e nëpunësve administrativ dhe personave tjerë të punësuar në ministrinë të cilët nuk kanë status të nëpunësve administrativ, nëse me ligj ndryshe nuk është përcaktuar.

(2) Drejtori i cili udhëheq me organin e pavarur të administratës shtetërore, përkatësisht me organizatën administrative, e përfaqëson organin e administratës shtetërore, organizon dhe siguron kryerje ligjore dhe efikase të punëve dhe detyrave; miraton rregullore dhe akte tjera për të cilat është i autorizuar dhe ndërmerr masa tjera nga kompetenca e organit të administratës shtetërore në përputhje me ligj; vendos për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e nëpunësve administrativ dhe personave tjerë në organin e administratës shtetërore, të cilët nuk kanë status të nëpunësve, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 50

(1) Drejtori i cili udhëheq me organin e pavarur të administratës shtetërore, përkatësisht me organizatën administrative personalisht është përgjegjës para Qeverinë për punën e tij, për punën e organit, përkatësisht organizatës me të cilën udhëheqë, si dhe për gjendjen në sferën kompetente në suaza të kompetencës së përcaktuar me ligj.

(2) Drejtori i cili udhëheq me organin e pavarur të administratës shtetërore, përkatësisht organizatën administrative, është i detyruar në Qeveri të dorëzojë për miratim planin vjetor të punës së organit më

së voni deri më 1 dhjetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm, raportin gjysmëvjetor më së voni deri më 31 korrik dhe raportin vjetor të punës së organit më së voni deri më 31 janar për vitin paraparak.

(3) Drejtori i organit në përbërje me ministrinë, personalisht është përgjegjës për punën e tij dhe për punën e organit me të cilin udhëheq para Qeverisë dhe para ministrit.

(4) Drejtori i cili udhëheq me organin në kuadër të ministrisë është i detyruar të ministri resorjal të dorëzojë për miratim planin vjetor të punës së organit më së voni deri më 1 dhjetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm, raportin gjysmëvjetor më së voni deri më 31 korrik dhe raportin vjetor të punës së organit më së voni deri më 31 janar për vitin paraparak.

Neni 51

Drejtorit të organit të pavarur të administratës shtetërore, përkatësisht organizatës administrative Qeveria mund t'i emëron zëvendës.

Neni 52

(1) Ministri mund të autorizojë nëpunës administrativ të sjell vendime në punët administrative.

(2) Ministri mund të autorizojë nëpunës administrativ të nënshkruaj akte, të vendos për çështje të caktuara dhe të kryen punë tjera nga kompetenca e ministrisë, përveç për aktet dhe punët të cilat në përputhje me ligj janë në kompetencë të ministrit.

(3) Drejtori i cili udhëheq me organ të pavarur, përkatësisht organizatë administrative mund të autorizojë nëpunës shtetëror të sjell vendime në punët administrative.

(4) Drejtori nga paragrafi (3) i këtij neni mund të autorizojë nëpunës shtetëror të nënshkruaj akte, të vendos për çështje të caktuara dhe të kryen punë tjera nga kompetenca e organit, përveç për aktet dhe punët të cilat në përputhje me ligj janë në kompetencë të drejtorit.

Neni 53

Organet e administratës shtetërore që kryejnë punë inspektuese janë të obliguara për kryerjen e punëve inspektuese me interes të përbashkët të bashkëpunojnë ndërmjet vete, si dhe me organe tjera të administratës shtetërore.

Neni 54

(1) Nëse në mes ministrive krijohet mosmarrëveshje me kompetencat ose paraqiten çështje tjera të diskutueshme në kryerjen e punëve nga kompetenca e tyre, këta ministri janë të obliguara të formojnë grup ndërministror për zgjedhje të çështjeve të diskutueshme.

(2) Nëse nuk arrihet marrëveshje ministritë janë të obliguara ta informojnë Qeverinë.

(3) Qeveria do ta shqyrtojë çështjen e diskutueshme dhe do t'ju jep drejtime ministrive për zgjidhjen e saj.

V. AKTE TË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Neni 55

(1) Ministri sjell rregullore, urdhra, udhëzues, plane, programe, vendime dhe lloje tjera të akteve për zbatim të ligjeve dhe rregulloreve tjera, kur për atë është i autorizuar me ligj.

(2) Drejtori i organit të pavarur të administratës shtetërore, përkatësisht organizata administrative sjell rregullore, vendime, urdhra, udhëzues, plane, programe dhe lloje tjera të akteve për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera, kur për atë është i autorizuar me ligj.

Neni 56

(1) Me rregullore përcaktohen dhe përpunohen dispozita të veçanta të ligjeve dhe rregulloreve tjera për shkak të zbatimit të tyre.

(2) Me urdhër urdhërohet ose ndalohet veprimi në situatë të caktuar e cila ka rëndësi të përgjithshme për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera.

(3) Me udhëzues përcaktohet mënyra e veprimit në zbatimin e dispozitave të veçanta të ligjeve dhe rregulloreve tjera.

(4) Me plan dhe program përcaktohen dhe përpunohen çështje të caktuara për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera për të cilat është i nevojshëm përcaktimi i afateve dhe dinamikave për zbatimin e tyre.

Neni 57

(1) Në procedurën administrative dhe në vendosjen e çështjeve të veçanta, si dhe në raste tjera të parapara me ligj dhe rregullore tjetër, ministri sjell vendime.

(2) Në procedurën administrative dhe në vendosjen për çështje të veçanta, si dhe në raste tjera të parapara me ligj dhe rregullore tjetër, drejtori i cili udhëheq me organin e pavarur të administratës shtetërore dhe organizatën administrative sjell vendime.

Neni 58

Ministri i cili udhëheq me ministrinë, në përbërje të së cilës gjendet organ tjetër i administratës shtetërore, me propozim të drejtorit i cili udhëheq me organin në përbërje, i sjell aktet për organin që është në përbërje të saj.

Neni 59

Nëse ministri është i autorizuar të sjell rregullore në marrëveshje me ministër tjetër, kurse marrëveshja e tillë në mes tyre nuk është arritur, ministrat për çështjen e diskutueshme janë të obliguar ta njoftojnë Qeverinë dhe të veprojnë sipas udhëzimit që ajo do ta jep.

Neni 60

(1) Ministri mund të sjell instruksione obliguese për kryerje të punëve që si autorizime publike me ligj iu janë besuar t'i kryejnë ndërmarrjet publike dhe personat tjerë juridik dhe fizik, si dhe njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit.

(2) Drejtori i cili udhëheq me organ të pavarur të administratës shtetërore, përkatësisht organizatë administrative mund të sjell instruksione obliguese për kryerje të punëve që si autorizime publike me ligj iu janë besuar t'i kryejnë personat juridik dhe fizik, si dhe njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qytetit të Shkupit.

Neni 61

(1) Me aktet të cilat i sjell ministri nuk mund për qytetarët dhe personat tjerë juridik të përcaktohen të drejta dhe obligime, as të përcaktohet kompetenca e organeve tjera.

(2) Me aktet të cilat i sjell drejtori i cili udhëheq me organin e pavarur të administratës shtetërore, përkatësisht me organizatën administrative nuk mundet për qytetarët dhe personat tjerë juridik të përcaktohen të drejtat dhe obligimet, as të përcaktohet kompetenca e organeve tjera.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 62

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji:

- Ministria e Biznesit dhe Ministria e Tregtisë bashkohen në Ministrinë e Ekonomisë dhe vazhdojnë me punë si Ministri e Ekonomisë me kompetenca të përcaktuara me këtë ligj;
- Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shkencës bashkohen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe vazhdojnë me punë si Ministri e Arsimit dhe Shkencës me kompetenca të përcaktuara me këtë ligj;
- Ministria e Emigracionit shfuqizohet, kurse punët nga kompetenca e saj kalojnë në kompetencë të Agjencisë për emigracion;
- Ministria për të Rinj dhe Sport shfuqizohet, kurse punët nga kompetenca saj kalojnë në kompetencë të Agjencisë për të rinj dhe sport;
- Ministria e Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë shfuqizohet, kurse punët nga kompetenca e saj kalojnë në kompetencë të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve;
- Ministria për Informatikë shfuqizohet, kurse punët nga kompetenca e saj kalojnë në Agjencinë për informatikë;
- Ministria për Zhvillim Shfuqizohet, kurse punët nga kompetenca e saj kalojnë në kompetencë të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Vetadministrimit Lokal;
- Ministria e Komunikacionit dhe Lidhjeve vazhdon me punë si Ministria e Transportit dhe Lidhjeve me kompetenca të përcaktuara me këtë ligj dhe
- Ministria e Mjedisit Jetësor vazhdon me punë si Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor me kompetenca të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 63

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji:

- Komisioni republikan për marrëdhënie me bashkësitë fetare vazhdon të punojë si Komision për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze dhe
- Drejtoria republikane gjeodete vazhdon të punojë si Ent shtetëror për punë gjeodete.

Neni 64

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji organizatat administrative:

- Enti për statistikë vazhdon të punojë si Enti shtetëror për statistikë;
- Enti hidrometeorologjik i Republikës së Maqedonisë shfuqizohet si organizatë e pavarur administrative dhe vazhdon të punojë si Drejtori për punë hidrometeorologjike, organ në përbërje me Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave;
- Arkivi i Republikës së Maqedonisë vazhdon të punojë si Arkiv shtetëror i Republikës së Maqedonisë dhe
- Enti për ekspertizë gjyqësore i Republikës së Maqedonisë shfuqizohet si organizatë e pavarur administrative dhe vazhdon të punojë si Byro për ekspertizë gjyqësore, organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 65

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji organet ekzistuese në përbërje:

- Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim vazhdon të punojë si Drejtori për siguri dhe kundërzbulim, organ në përbërje të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Inspektorati administrativ republikan vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror administrativ, organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë;
- Drejtoria për zbatim të sanksioneve vazhdon të punojë si Drejtori për zbatim të sanksioneve, organ në

përbërje të Ministrisë së Drejtësisë;

- Drejtoria republikane për punë pronësore juridike vazhdon të punojë si Drejtori për punë pronësore juridike, organ në përbërje të Ministrisë së Financave deri në përfundimin e procesit të implementimit të denacionalizimit, kurse më pas kalon në organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë me kompetenca të përcaktuara me ligj;
- Inspektorati republikan devizor vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror devizor, organ në përbërje të Ministrisë së Financave;
- Drejtoria republikane për të ardhura publike vazhdon të punojë si Drejtori për të ardhura publike, organ në përbërje të Ministrisë së Financave;
- Drejtoria për rezerva të mallrave vazhdon të punojë si Byro për rezerva të mallrave, organ në përbërje të Ministrisë së Financave;
- Drejtoria e monopolit vazhdon të punojë si organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë;
- Drejtoria republikane për prodhimtari të dedikuar vazhdon të punojë si Drejtori për prodhimtari të dedikuar, organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë;
- Inspektorati republikan i tregut vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror i tregut, organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë;
- Inspektorati republikan për inspeksion teknik vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror për inspeksion teknik, organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë;
- Drejtoria për turizëm vazhdon të punojë si Byro për turizëm, organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë;
- Enti për standardizim dhe metrologji vazhdon të punojë si Shërbim për standardizim dhe metrologji, organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë;
- Enti për mbrojtje të pronësisë industriale vazhdon të punojë si Byro për mbrojtje të pronësisë industriale, organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë;
- Drejtoria republikane për veterinar vazhdon të punojë si Drejtori për veterinar, organ në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;
- Drejtoria republikane për ekonomi të ujërave vazhdon të punojë si Drejtori për ekonomi të ujërave, organ në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;
- Inspektorati republikan për bujqësi dhe pylltari vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror për bujqësi, organ në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;
- Inspektorati republikan sanitar dhe shëndetësor vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror sanitar dhe shëndetësor, organ në përbërje të Ministrisë së Shëndetësisë;

- *Jashtë fuqisë*¹²

- Këshilli republikan pedagogjik vazhdon të punojë si Shërbim pedagogjik, organ në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- Enti pedagogjik i Maqedonisë vazhdon të punojë si Byro për zhvillim të arsimit, organ në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- Inspektorati republikan i arsimit vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror i arsimit, organ në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- Drejtoria republikane për çështje të luftëtarëve dhe invalidëve të luftës vazhdon të punojë si Drejtori për çështje të luftëtarëve dhe invalidëve të luftës, organ në përbërje të Ministrisë së Punëve dhe Politikës Sociale;
- Inspektorati republikan i punës vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror i punës, organ në përbërje të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale;
- Inspektorati republikan për vetadministrim lokal vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror për vetadministrim lokal, organ në përbërje të Ministrisë së Vetadministrimit Lokal;
- Agjencia për zonat ekonomike pamjaftueshëm të zhvilluara vazhdon të punojë si Byro për zona ekonomike pamjaftueshëm të zhvilluara, organ në përbërje të Ministrisë së Vetadministrimit Lokal;
- Drejtoria për telekomunikim vazhdon të punojë si Drejtori për Telekomunikim, organ në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve;
- Drejtoria për aviacion civil vazhdon të punojë si Drejtori për aviacion civil, organ në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.
- Inspektorati republikan për komunikacion dhe lidhje vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror për transport, organ në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve;
- Inspektorati republikan për ndërtimtari dhe urbanizëm vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror për ndërtimtari dhe urbanizëm, organ në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve;
- Inspektorati republikan komunal vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror komunal, organ në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve;
- Inspektorati republikan për mjedis jetësor vazhdon të punojë si Inspektorat shtetëror për mjedisin

jetësor, organ në përbërje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor;
- Enti për mjedis jetësor vazhdon të punojë si Shërbim për mjedis jetësor, organ në përbërje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor;
- Enti republikan për sistem informativ hapësinor vazhdon të punojë si Shërbim për sistem informativ hapësinor, organ në përbërje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni 66

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji Fondi për mjedis jetësor, e humb statusin e organit në përbërje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe vazhdon të punojë i pavarur si Fond për mjedis jetësor, organizimi dhe puna e të cilit përcaktohen me ligj.

Neni 67

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji Fondi për ujërat e humb statusin e organit në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe vazhdon të punojë i pavarur si Fond për ujërat, organizimi dhe puna e të cilit përcaktohen me ligj.

Neni 68

Agjencia për riparim dhe zhvillim vazhdon me punë si Agjenci për zhvillim dhe investime si organ i pavarur i administratës shtetërore.

Neni 69

Me ditën e fillimit me punë të Drejtorisë për zona të lira ekonomike, punët nga kompetenca e saj do t'i kryen Ministria e Ekonomisë.

Neni 70

Deri në sjelljen e ligjit me të cilin do të vërtetohen kompetencat e njësive të vetadministrimit lokal, kurse kur bëhet fjalë për punët e mbrojtjes nga zjarret vazhdon t'i kryen Ministria e Punëve të Brendshme, punët që kanë të bëjnë me kujdesin ndaj personave të moshuar vazhdon t'i kryen Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, kur bëhet fjalë për planifikimin urbanistik dhe përcaktimin e kushteve të ndërtimit i kryen Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 71

Të punësuarit, pajisja, inventari dhe punët tjera, arkivi, dokumentacioni, mjetet e punës dhe mjetet tjera nga ministritë të cilat bashkohen, përkatësisht shfuqizohen, nga organizatat administrative të cilat shfuqizohen dhe nga organet në përbërje të cilat bashkohen, përkatësisht kalojnë në ministri tjetër, merren në organet e administratës shtetërore në përputhje me këtë ligj.

Neni 72

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për organet e administratës ("Gazeta Zyrtare e RSM-së numër 40/1990 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 63/1994 dhe 63/1998).

Neni 73

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".